



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë B Tipologji tekstore (4)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 40 seminare
Viti / Semestri: Viti III , semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit“Bachelor në gjuhën ruse ‘Përkthim-Interpretim’”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të mësojë kërkimin bazë të tekstit; Të njihet me metodat dhe teknikat e analizave filologjike të tekstit. Të mësojë të planifikojë punën sipas etapave të caktuara. Të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi burimet e ndryshme dhe literaturën e shfrytëzuar.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të marrë në konsideratë tekstin si një formë të veçantë të komunikimit.
2. Të di kategoritë bazë dhe konceptet letrare.
3. Të njohë rregullsinë e ndërtimit të tekstit dhe qasjet kryesore në studimin e tij;
4. Të marrë në konsideratë tekstin si një unitet të përmbajtjes ideologjike.

Rezultatet e pritshme :

1. Aftësia për të përdorur bazat e dijes filologjike, për të formuar një botëkuptim;
2. Aftësia për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në gjuhën ruse.
3. Aftësia për të përmbushur sfidat e komunikimit ndërpersonal dhe ndërkulturor;
4. Aftësia e të kuptuarit të zhanreve të ndryshme të teksteve letrare dhe kulturore;
5. Aftësia për të aplikuar këto njohuri në fushën e historisë së gjuhës dhe letërsisë, teorisë së komunikimit, analizës filologjike dhe të interpretimit të tekstit në aktivitete të ndryshme shkencore;